



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

---

A.nr.483/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Arsim Hamzaj - kryesues, Kimete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dhe ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje me (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat Anr.483/2025 dhe Anr.502/2025, të datës 09.02.2025, të parashtuara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dhe subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e (LDK), ushtron ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendohet se LDK - Dega Prishtine ka verejtur se me rastin e vendosjes se postimit te kandidatit per deputet te LVV -Dimal Basha ne rrjetin social facebook eshte shkelur neni 37 paragrafi 1, nenparagrafi 1.2 i LZP-se dhe neni 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024. Bashkengjitur gjeni proven qe deshmon per shkeljen e tille ne ditën e zgjedhjeve. Andaj, duke u bazuar ne gjithë keto qe u thane me larte clhe provat e bashkengjitura kerkojme

nga anajuar si organ kompetent dhe i autorizuar qe te merrni Vendim meritor per rastin ne fjale, pra te shqiptoni mase sanksionuese nclaj subjektit politik LVV.

Poashtu me datën e njëjtë, PZAP-i, ka pranuar një ankesë Anr.502/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e (PDK), të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendohet se me datë 09 shkurt 2025, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Dimal Basha ka shpërndarë një postim në Facebook Story, duke bërë thirrje për votim të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje si dhe numrit kandidaturës së tij nga radhët e këtij subjekti politik. Në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë për bazë shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e kandidatëve të Lëvizjes Vetëvendosje, nga PZAP kërkohet që të nxjerrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 10.02.2025, Subjekti Politik LVV, ka theksuar se nga prova e bashkangjitur vërejmë kohën kur është bërë screenshot ky postim figuron ora 8:36, ndërsa postimi thuhet se është bërë para 1 ore, cka vrojtuesin e thjeshtë e bën të mendoj se ky postim ka ndodhur pas orës 07:00 atëherë edhe kur janë hapur vend votimet. Mirëpo rrjeti social facebook "rrumbullakson" orët kur postimi është publikuar, çka e bën të mundur që ky postim të jetë vendosur ne facebook nga ora 06:36 minuta e deri 06:59 minuta dhe ende të figuroj që ka vetëm 1 orë që është postuar. Tutje ka shtuar se kjo dëshmohet edhe nga verifikimi i saktë i orës së postimit të deputetit Dimal Basha, ku figuron se është pikërisht intervali 06:50 min momenti kur është postuar, fakt ky që mund të verifikohet lehtë në facebook, duke e bërë postimin të mos jetë shkelje e heshtjes zgjedhore.

Andaj bazuar në argumentet e sipërsënuara, pas shqyrtimit të gjitha provave dhe argumenteve të parashtruara nga palët, kanë propozuar PZAP-së që të refuzohet si e pabazuar Ankesa Anr.483/2025 dhe Anr.502/2025 e palës parashtruese, kundër Lëvizjes VETËVENDOSJE!

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.483/2025, Anr.502/2025, të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.483/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga dy subjekte politike kundër subjektit të njëjtë politik LVV për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

## **-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike dhe Partia Demokratike, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 par. 1 nën par. 1.2 të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"1.Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; 1.2.bërja e fushatës në çfarëdo mënyre", e as shkelje nga neni 8 par.1, nën par.1 të Rregullës Zgjedhor 07/2024, ku parasihet se "Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprimet më poshtë: .....1.5.shfrytëzimi i mediave locale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi"*.

Pretendimet ankimore të parashtruesve të ankesave lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesit e ankesave, në ankesat e tyre kanë bashkangjitur postimet e kandidatit në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjtit postimin e ka bërë pas fillimit të votimit, përkatësisht pas hapjes së Qendrave të Votimit për Votim, pasi që nga provat e parashtruar dhe hetimit të bërë nga Paneli është vërtetuar se postimi i kandidatit në fjalë është bërë në ora 06.50 minuta, që i bie se është bërë 10 minuta para hapjes së Qendrave të Votimit, e që sipas vlerësimit të Panelit zgjedhore dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përmendura më lartë.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, në ndërkohë që me provat tjera është vërtetuar se ky postim ka ndodhur para hapjes së Qendrave të Votimit. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesit e ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.483/2025, datë 11.02.2025



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.